



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

---

Prishtinë, më 2 qershor 2016  
Nr. ref.:RK944/16

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

**rastin nr. KI01/15**

Parashtrues

**Fahredin Gashi**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës  
Supreme të Kosovës, nr. Pml Kzz. 157/2014, të 2 tetorit 2014**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Fahredin Gashi, me vendbanim në Shtime (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga z. Tahir Rrecaj, avokat në Prishtinë, Kosovë.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Pml. Kzz 157/2014, të 2 tetorit 2014, dhe, rrjedhimisht, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR 1175/2012, të 10 marsit 2014, dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë P. Nr. 371/2010, të 23 nëntorit 2011.
3. Vendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 3 nëntor 2014.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. Kzz 157/2014, të 2 tetorit 2014.
5. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar është në kundërshtim me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe nenin 2 të Protokollit VII të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ), nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR), dhe nenin 14 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP).

## **Baza juridike**

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenin 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregulloja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

7. Më 9 janar 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 13 janar 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin GJR. KI01/15, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin KSH. KI01/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
9. Më 27 mars 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai ta dorëzojë autorizimin.
10. Të njëjtën ditë, Gjykata ia dorëzoi kopjen e kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës, Prokurorit të Shtetit të Kosovës dhe Prokurorisë Speciale të Kosovës.

11. Më 1 prill 2015, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi autorizimin.
12. Më 5 maj 2015, Prokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës dorëzoi përgjigjen në Gjykatën Kushtetuese ndaj kërkesës së parashtruesit.
13. Më 6 maj 2015, Gjykata ia dorëzoi parashtruesit të kërkesës kopjen e parashtrësës së Prokurorit të Shtetit të Kosovës.
14. Më 1 korrik 2015, me Vendimin KSH. KIO1/15, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović anëtar të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Kadri Kryeziu, mandati i të cilit në Gjykatën Kushtetuese kishte përfunduar më 26 qershor 2015.
15. Më 15 mars 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

16. Më 15 qershor 1999, në fshatin Vorigovc, në komunën e Lipjanit, S. G. ishte vrarë derisa ishte duke fjetur në shtëpinë e tij. Parashtruesi i kërkesës ishte shoqëruar nga N. B. dhe ishte dënua për veprën penale Krime të luftës kundër popullsisë civile për vrasjen e S. G.
17. Më 23 nëntor 2011, parashtruesi u dënua nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës (Aktgjykimi P. nr. 371/10) për veprën penale të Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile, nga nenet 22 dhe 142 të Kodit Penal të RSFJ-së, neni i përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949, dhe neni 4 i Protokollit II të 8 qershorit 1977, shtesë i Konventave të Gjenevës. Gjykata dënoi parashtruesin me 18 (tetëmbëdhjetë) vjet burgim, në të cilin ishte llogaritur në dënim koha e kaluar në arrest shtëpiak nga 14 korriku 2010 deri më 18 gusht 2010 dhe në paraburgim që nga 19 gushti i vitit 2010.
18. Në lidhje me dëshminë e të bashkëpandehurit të parashtruesit, përkatësisht dëshmitarit bashkëpunues N. B., Gjykata e Qarkut bëri gjetje të detajuara dhe të qarta.
19. Më 16 maj 2012, mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës ushtroi ankesë ndaj Aktgjykimit në Gjykatën kompetente të instancës së dytë në atë kohë, Gjykatën Supreme të Kosovës, për shkak të: (i) shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës penale (neni 403, paragrafi 1, nënparagrafi 12 dhe paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës - 2004 (në tekstin e mëtejme: KPPK); (ii) vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike (neni 405, paragrafi 3, i KPPK-së); Shkelje të ligjit penal (neni 404, paragrafi 1, nënparagrafi 4 i KPPK-së në lidhje me nenin 2, paragrafi 2 i Kodit Penal të Kosovës - 2004 (në tekstin e mëtejme: KPK)); dhe (iv) vendimit për sanksionin penal (në ankesë nuk është përmendur asnjë nen i KPPK-së). Në këtë kontekst, mbrojtësi propozoi që ankesa të aprovohej, aktgjykimi i kontestuar të ndryshohej ashtu që i akuzuari të lirohej nga të gjitha akuzat, apo, në mënyrë alternative, që

aktgjykimi të anulohet dhe çështja të kthehet për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

20. Më 10 shkurt 2014, Gjykata e Apelit, tani gjykata kompetente e shkallës së dytë, pas mbajtjes së seancës për dëgjim të argumenteve të avokatit mbrojtës të parashtruesit të kërkesës dhe prokurorit në lidhje me ankesën kundër aktgjykimit.
21. Pas kësaj, Gjykata e Apelit pranoi pjesërisht ankesën e parashtruar në emër të parashtruesit të kërkesës, dhe reduktoi dënimin nga 18 (tetëmbëdhjetë) në 14 (katërmëdhjetë) vjet burgim.
22. Gjykata e Apelit, në shqyrtimin e vendimit për dënim dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut nxori konkluzionet e detajuara dhe eksplicite si në vijim në lidhje me besueshmërinë e dëshmitarit bashkëpunues N. B. dhe mjaftueshmërinë e provave në këtë rast.
23. Më 5 qershor 2014, avokati mbrojtës parashtrroi kërkesë në Gjykatën Supreme të Kosovës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë për shkak të: (i) shkeljes së ligjit penal (neni 404, paragrafi 1, nënparagrafi 4 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) në lidhje me nenet 22 dhe 142 të KPK); dhe (ii) shkeljes substanciale të dispozitave të procedurës penale neni 403, paragrafi 1, nënparagrafët 3, 8 dhe 12, dhe paragrafi 2 i KPPK-së).
24. Më 2 tetor 2014, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Pml. Kzz 157/2014, vërtetoi dënimin e parashtruesit për Krime lufte kundër popullsisë civile, por e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit për të përfshirë dhe llogaritur në dispozitiv edhe kohën e kaluar në arrest shtëpiak prej 14 korrikut 2010 deri më 18 gusht 2010, dhe në paraburgim që nga 19 gushti 2010 do të llogaritet në dënim.
25. Gjykata Supreme duke vlerësuar kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë, shqyrtoi me kujdes drejtësinë e procedurave të gjyimit dhe trajtimit të provave dhe gjeti se ka pasur prova thelbësore për të mbështetur aktgjykimin dhe se procedura ishte e drejtë.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij në pajtim me nenet 24 dhe 31 të Kushtetutës, nenin 6 dhe nenin 2 të Protokollit VII të KEDNJ-së, dhe nenin 14 të KNDCP-së nga gjykatat e rregullta të Kosovës në aktgjykimin e 23 nëntorit 2011, me të cilin e kishte shpallur atë fajtor për krime të luftës kundër popullsisë civile.
27. Ai në mënyrë specifike pretendon se atij i është mohuar e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sepse:

- a. Konfirmimi i aktakuzës është bërë pa u mbajtur asnjë seancë formale për konfirmimin e aktakuzës;
- b. Vendimit dhe aktgjykimit të gjykatës i mungonte arsyetimi;
- c. Shkelja e parimit të “kontradiktoritetit”;
- d. Shkelja e dispozitave esenciale të Kodit të Procedurës Penale;
- e. Prania e të akuzuarve të tjerë përderisa parashtruesi i kërkesës ishte intervistuar në procedurë;
- f. Shkelja e parimit të barazisë së armëve;
- g. Shkelja e parimit *dubio pro reo*;
- h. Mosadministrimi i provave të dorëzuara;
- i. Mbajtja e seancës përkundër gjendjes shëndetësore/mendore të parashtruesit të kërkesës;
- j. Mungesa e shqyrtimit të tërësishëm të ankesës;
- k. Argumentimi i Aktgjykimit vetëm në deklaratat e dëshmitarit bashkëpunues; dhe
- l. Ai nuk ka marrë vendimin me shkrim në një periudhë të arsyeshme kohore.

28. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që:

- a. Ta deklarojë kërkesën e parashtruesit të pranueshme;
- b. Të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore, në pajtim me rregullin 39 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës; dhe
- c. Të konstatojë cenimin e të drejtave individuale të parashtruesit të garantuara me nenet 24 dhe 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenin 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut; nenin 14 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, si rezultat i shkeljeve nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, Gjykata e Apelit e Kosovës dhe nga Gjykata Supreme e Kosovës.

### **Përgjigja e Kryeprokurorit të Shtetit**

29. *“Prokurori i Shtetit pohon se kërkesa e parashtruesit nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 29, paragrafin 2, pikat (e), (f) dhe (g) të Rregullores së punës. Prokurori i Shtetit pretendon se është plotësisht e paqartë se cili vendim kontestohet nga parashtruesi i kërkesës në Gjykatë. Kërkesa nuk flet për të drejtat dhe liritë kushtetuese të cilat parashtruesi pretendon se i janë shkelur. Parashtruesi nuk arrin të japë hollësi të qarta dhe koncize të fakteve themelore dhe nuk arrin të demonstrojë lidhjen midis këtyre fakteve dhe shkeljes së pretenduar. Në fund, Prokurori i Shtetit pretendon se në kërkesë nuk është saktësuar asnjë mjet lehtësues”.*

## Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili përcakton se:

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

33. Përveç kësaj, Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) të Rregullores së punës, të cilat parashohin se:

*“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

*[...]*

*(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*

*(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

*(a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose*

*(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose*

*(c) Gjykata gjen që parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të drejtave të garantuara me Kushtetutë; ose*

*(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

34. Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit lidhen kryesisht me mënyrën në të cilën ishin trajtuar provat e paraqitura nga dëshmitari bashkëpunues N.B.

Parashtruesi konsideron se dëshmitari bashkëpunues nuk ishte i besueshëm dhe se nuk kishte prova të mjaftueshme të tjera për të vërtetuar këtë dëshmi. Parashtruesi pretendon se gjykatat nuk kanë shqyrtuar në mënyrë adekuate besueshmërinë e dëshmitarit bashkëpunues në arritjen e aktgjykimeve të tyre, dhe nuk ka marrë parasysh argumentet e tij për këtë besueshmëri.

35. Gjykata i referohet nenit 31 të Kushtetutës, i cili, *inter alia*, thekson:

*“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*

*2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

[...]

*4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.*

*5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.*

[...]”

36. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 6 të KEDNJ-së, i cili, *inter alia*, thekson:

*“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj [...].*

*2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht.*

*3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:*

[...]

*d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;*

[...]”

37. Gjykata rikujton se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, që ka të bëjë me të drejtën për gjykim të drejtë, në thelb merret me faktin nëse parashtruesit të kërkesës i janë ofruar mundësi të shumta që ta parashtrojë rastin e tij dhe të kontestojë prova që ai i konsideronte të rreme. E drejta për gjykim të drejtë, e mishëruar në Kushtetutë dhe KEDNJ nuk kanë të bëjnë me çështjen nëse gjykatat vendase kishin nxjerrë një vendim të drejtë apo të gabuar në lidhje me faktet e vërtetuara apo ligjin.
38. Gjykata konsideron se për të konstatuar se parashtruesi nuk ka pasur një gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës ose të nenit 6 të KEDNJ-së, kjo Gjykatë do të duhej të konstatojë se vendimi për dënim dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk ishin të arsyetuara. Përveç kësaj, Gjykata do të duhet të konstatojë se dëshmitë e dëshmitarit bashkëpunues nuk ishin mbështetur sa duhet në mënyrë që ajo të jetë mjaft e besueshme, për të mbështetur përtej dyshimit të arsyeshem vendimin për dënim dhe aktgjykimin.
39. Gjykata rikujton se nëse aktgjykimi për dënim nuk është i arsyetuar, ekziston supozimi se i pandehuri nuk ka pasur gjykim të drejtë. Gjykata, gjithashtu, vëren se aktgjykimi për dënim nuk mund të bazohet vetëm në dëshminë e pambështetur të dëshmitarit bashkëpunues.
40. Megjithatë, kjo Gjykatë nuk mund të zëvendësojë gjykimin e saj me atë të Gjykatës së Qarkut në lidhje me atë se çfarë dëshmuar apo nuk dëshmuar provat në rastin e parashtruesit të kërkesës. Për të gjetur se ka pasur shkelje kushtetuese të së drejtës për gjykim të drejtë në këtë rast në lidhje me mjaftueshmërinë e provave, kjo Gjykatë do të duhej të gjejë se jo vetëm arsyetimi i Gjykatës së Qarkut, por edhe arsyetimi i Gjykatës së Apelit, si dhe ai i Gjykatës Supreme në lidhje me mbështetjen e dëshmisë së dëshmitarit bashkëpunues, kishte aq të meta sa që nuk kishte asnjë mbështetje dhe se aktgjykimet e tyre nuk ishin të arsyetuara.
41. Kjo Gjykatë nuk mund ta bëjë këtë konstatim në këtë rast. Në të vërtetë, Gjykata e Qarkut, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë dhënë konstatime të detajuara faktike në lidhje me besueshmërinë e dëshmitarit bashkëpunues dhe provave shtesë mbështetëse në favor të vendimit për dënim dhe se është dëshmuar se parashtruesi është fajtor përtej dyshimit të arsyeshem për kryerjen e krimeve të luftës kundër popullsisë civile.
42. Prandaj, Gjykata konkludon se ky pretendim duhet të refuzohet si i papranueshem.
43. Sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Procedurës Penale, parimit të barazisë së armëve dhe lëshimit të pretenduar të Gjykatës së Qarkut që t'i pranojë disa nga provat e propozuara, refuzimi nga gjykata i mbrojtjes së alibisë së parashtruesit dhe fakti se ai nuk ka pranuar një aktgjykim me shkrim për fajësi në periudhën e përcaktuar me Kodin e Procedurës Penale, parashtruesi nuk ka arritur të tregojë se si cilado nga këto shkelje të pretenduara, në qoftë se ato kanë ndodhur, ka rezultuar me shkeljen e së



drejtës së tij kushtetuese për gjykim të drejtë. Prandaj, këto pretendime duhet gjithashtu të refuzohen si të papranueshme.

44. Sa i përket asaj nëse problemet e pretenduara shëndetësore të parashtruesit të kërkesës mund t'ia kenë mohuar atij të drejtën për ta ndihmuar në mënyrë efektive avokatin e tij në mbrojtjen e tij gjatë gjykimit, Gjykata vëren se nuk ka prova se parashtruesi ose avokati i tij kanë ngritur ndonjëherë formalisht këtë çështje në kohën e duhur në Gjykatën e Qarkut para ose gjatë gjykimit. Madje, nuk ka asnjë dëshmi se parashtruesi i kërkesës ka vuajtur nga ndonjë problem shëndetësor në atë masë sa që ai nuk ka mundur ta ndihmojë avokatin e tij në përgatitjen e një mbrojtjeje adekuate gjatë gjykimit të tij.
45. Gjykata thekson se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet e nxjerra nga Gjykata Supreme. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë ato prova (Shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut, i 10 korrikut 1991).
46. Në rastin konkret, Gjykata nuk ka gjetur se procedurat përkatëse në Gjykatën Supreme, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, GJEDNJ Aktvendim për pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06 të 30 qershorit 2009).
47. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur pretendimin e tij mbi baza kushtetuese dhe nuk ka ofruar prova që tregojnë se si dhe pse janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij, të mbrojtura me Kushtetutë, me vendimin e kontestuar.
48. Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) (d) të Rregullores së punës.


## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2) (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 15 mars 2016, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për seancë dëgjimore;
- III. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


**Gjyqtari raportues**



Robert Carolan



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**



Arta Rama-Hajrizi